

VENDIM
Nr. 74/2020

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT TË POSAÇËM “PËR ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE HARTIMIN E NJË RAPORTI PËRMBLEDHËS DHE INFORMUES PËR GJETJET DHE KONKLuzionET QË KANË NXJERRË VERIFIKIMET E KRYERA NGA INSTITUCIONET PËRKATËSE NË SHQIPËRI, PËR ÇËSHTJET E RAPORTIT TË ANËTARIT TË ASAMBLESË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS, *DICK MARTY*, PËR BASHKËPUNIMIN DHE ROLIN PËR TË CILIN PRETENDOHET SE KANË LUAJTUR PËRFAQËSUES POLITIKË SHQIPTARË OSE INSTITUCIONE PUBLIKE SHQIPTARE, NËPËRMJET VEPRIMEVE DHE MOSVEPRIMEVE, NË NDIHMË TË SË ASHTUQUAJTURËS VEPRIMTARI KRIMINALE E DREJTUESVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NGRITUR ME VENDIMIN NR. 71/2020 TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 24, pika 3, dhe 55, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e komisionit të posaçëm “Për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues për gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri, për çështjet e raportit të anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, *Dick Marty*, për bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë”, ngritur me vendimin nr. 71/2020 të Kuvendit është si më poshtë:

- | | | |
|--------------------|-----------------|--|
| 1. Ulsi Manja | kryetar | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |
| 2. Enver Roshi | zëvendëskryetar | (Grupi Parlamentar “I pavarur”) |
| 3. Klotilda Bushka | sekretare | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |
| 4. Ermonela Felaj | anëtare | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |
| 5. Alket Hyseni | anëtar | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |
| 6. Adnor Shameti | anëtar | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |
| 7. Edmond Stojku | anëtar | (Grupi Parlamentar “Demokraci dhe Drejtësi”) |
| 8. Myslim Murrizi | anëtar | (Grupi Parlamentar “Demokrat”) |
| 9. Elena Xhina | anëtar | (Jashtë grupeve parlamentare) |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.12.2020.